



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:145349

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05633294

KPPP.nr.1720/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., me seli në Gjakovë, rruga “Mbretëresha Teuta” p.n., kundër debitorit Restorant “Relax”, me seli në Rahovec, fshati Brestoc, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit E.nr.48/2012 të datës 01.02.2012, të Gjykatës Komunale në Rahovec, jashtë seancës me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Restorant “Relax” dhe Aktvendimi E.nr.48/2012 i datës 01.02.2012, i lejuar nga Gjykata Komunale në Rahovec, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale në Rahovec, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., ka lejuar përmbartimin sipas Aktvendimit E.nr.48/2012 të datës 01.02.2012, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.9027361 të datës 04.01.2012, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumë të përgjithshme prej 2,163.98 €, me kamatë ligjore prej 3.5 %, nga dita e dorëzimit të propozimit në gjykatë e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në vlerën e borxhit.

Debitorët në kundërshtimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar ndër të tjerash se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar ekzekutimi mban përshkrimin se borxhi është krijuar në bazë të konsumit të energjisë elektrike deri me 01.01.2012, duke mos përfshirë se për cilën

periudhë është konsumuar sasia e përshkruar e energjisë elektrike andaj si e tillë e njëjta është e mangët dhe nuk mund të paraqesë bazë për lejimin e përmbarrimit të propozuar. Tutje ka shtuar se debitori rregullisht ka paguar faturat mbi shpenzimin e energjisë elektrike, shuma që kërkohet nga kreditori është shumë të cilën pa asnjë bazë e ka faturuar kreditori në formë të paushallit me vlerë prej 33% mbi shumën e faturuar. Gjykatës i ka propozuar që ta pezulloj procedurën përmbarrimor.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me aktvendimin E.nr.48/2012, të datës 03.06.2015, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimin E.nr.48/2012 të datës 01.02.2012, për caktimin e përmbarrimit i lejuar nga Gjykata Komunale në Rahovec.

Debitori me datë 19.06.2015, ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa, ndërsa aktvendimi i shkallës së parë të abrogohet, si dhe ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.4552/2015 të datës 22.07.2016, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm,*

mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr. Nr.9027361 e datës 04.01.2012, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarim dhe është lejuar përmbarimi është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, e rrjedhimisht propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit E.nr.48/2012 i datës 01.02.2012, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar përmbarimi.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktvendimit për përmbarim, ndërsa organi përmbarues – Gjykata Komunale në Rahovec, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”,* gjykata shfuqizoi aktvendimin përmbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1720/23, datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.